



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDER KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TE ORGANIZUAR

Nr. 386/Prot./M.K.

Tiranë, më 23.04.2021

Lënda: Përcillet për kompetencë materiali kallëzues

Drejtuar: PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

TIRANË

Për dijeni : PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË

TIRANË

Me shkresën nr. 77 prot datë 21.04.2021 është depozituar një kallëzim penal nga subjekti Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga z. G.Bardhi, (regjistruar me tonën me nr386 datë 22.04.2021) me pretendimin se janë konsumuar veprat penale të “Shpërdorimit të detyrës”, “Korrupsion aktiv në zgjedhje”, “Përdorim të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” dhe “Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” parashikuar nga nenet 248, 328, 328/a dhe 245/1 të Kodit Penal.

Pas studimit të hollësishëm të kallëzimit rezulton se nuk ka të dhëna për veprën penale të “Korrupsionit aktiv në zgjedhje”, apo “Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” parashikuar nga nenet 328, 245/1 të Kodit Penal. Në tërësinë e kallëzimit pretendohet për disa orientime të dhëna nga shtetasi [REDACTED] stafit të tij, gjatë kryerjes së detyrës së tij, veprime/biseda këto që duhet të vlerësohen nga organi procedues në kuadër të veprave penale “Shpërdorimit të detyrës”, dhe “Përdorim të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” të parashikuar nga nenet 248 dhe 328/a të Kodit Penal.

Ndodhur në këto kushte pamvarësisht pretendimit të kallëzuesit se cilat vepra penale janë kryer, konstatohet që materiali referon për vepra penale që nuk janë në kompetencë të Prokurorisë tonë referuar nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, apo subjekte të Posaçëm referuar nenit 3 të Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Për këtë arsye ju përcjellim materialin kallëzues për vlerësim nga ana juaj.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DREJTUESI I PROKURORISË

